



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

Nr. 226/1 prot.

Korçë, më 10 . 04 .2025

Lënda: Kthim Përgjigje

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 949 prot, datë 11.03.2025, “Kërkesë për informacion mbi zbatimin e ligjit nr. 33/2022 - Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, protokolluar pranë Këshillit të Qarkut Korçë me nr. 226 prot, datë 13.03.2025, në vijim të kërkesës suaj ju bëjmë me dije se lista me dokumenta ekzistuese, të cilat do të vihen në dispozicion në formatin e të dhënave të hapura në platformat online, janë të kategorizuara si më poshtë:

1. Të Dhënat e Administruar nga Institucioni:

- Të dhënat që lidhen me administratën publike dhe shërbimet që ofrohen për publikun.
- Organigrami dhe struktura e institucionit.
- Të dhënat që lidhen me politikat dhe aktet e miratuara nga institucioni i Këshillit të Qarkut Korçë.
- Konkursi për pozita të reja në administratën publike, duke përfshirë përshkrimin e punës, kriteret dhe rezultatet e konkursit.
- Të dhënat për të drejtat dhe detyrimet ligjore të qytetarëve dhe palëve të tjera.
- Të dhëna lidhur me popullsinë, ekonominë, mjedisin dhe të tjera, të mbledhura nga autoritetet statistikore të qarkut.

2. Të Dhënat për Shpenzimet Publike dhe Buxhetin:

- Raportet mbi shpenzimet dhe burimet financiare të Institucionit të Këshillit të Qarkut Korçë.
- Informacion për ndarjen dhe alokimin e fondeve publike në përputhje me kërkesat ligjore.

3. Të Dhënat e Shërbimeve Publike, Kontratat Publike dhe Marrëveshjet e Bashkëpunimit me Institucione të Tjera:

- Shërbimet dhe mundësitë që ofrohen për qytetarët dhe bizneset.
- Të Dhënat/ Njoftime për Tenderët dhe Kontratat Publike.
- Marrëveshjet e Bashkëpunimit me Bashkitë e Qarkut apo aktorë të tjerë publikë ose privatë.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se rubrika “Të Dhëna të Hapura” në *website* të Këshillit të Qarkut Korçë është krijuar dhe personi përgjegjës për implementimin e ligjit, sipas kërkesës suaj do të jetë **Znj. Maria Furxhi**, Koordinatore për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

KRYETARI

Erjon Nexhipi



Koncept: *M. Furxhi*